



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 01.10.2013
Nr. 0204-1258

PËR: Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës
Hazir Raçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS, Nr. 01-353-10432, të pranuar me datën 27.09.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin NR. 04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 01-353-10432, të miratuar me datë 26.09.2013 nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr. 01-353-10432, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë së përbashkët për fshatrat Dobërdol dhe Zakut.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 01.10.2013
br. 0204-1258

Za: Agim Veliu, Gradonačelnik opštine Podujevo
Hazir Raçi, Predsedavajući Skupštine opštine Podujevo

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Podujevo , br. 01-353-10432,
primljeno dana 27.09.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 01-353-10432, **odobreno dana 26.09.2013** od strane Skupštine opštine Podujevo , **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

Odluka br. 01-353-10432, o određivanje lokacije za izgradnju zajedničke Džamije za sela Dobërdol i Zakut.

Sa poštovanjem.

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: *Beshnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të neneve 14.1 dhe 17 shkronja s të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 19 shkronja s të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-1/298-10, dhe nenit 10 parag. 1.4 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2013, miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E XHAMISË SË PËRBASHKËT PËR FSHATRAZ DOBËRDOL DHE ZAKUT

Neni 1

Për ndërtimin e Xhamisë së përbashkët për fshatrat Dobërdol dhe Zakut caktohet lokacioni i evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtën e Pronës së Paluajtshmërisë nr. UL-71712024-00147, në parcelën kadastrale nr.71712024-00547-0, pjesë në sipërfaqe prej 1000m² kultura kullosë vendi i quajtur "Fshati", Zona kadastrale Dobërdol.

Neni 2

Kushtet tekniko-urbanistike për ndërtimin e objektit të Xhamisë i cakton Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje së Mjedisit.

Neni 3

Zbatimin e këtij vendim e bën Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.


Neni 4

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-353-10432

Podujevë,

26 shtator 2013



Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi